

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

10 Tetor 2014

Të dashur Prindër/Kujdestarë:

Në datën 10 Gusht të vitit 2013, Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë (PDE) ka marrë kërkesa për heqje dorë nga 10 kërkesat e Aktit për Edukimin në Shkollat Filllore dhe të Mesme (ESEA) të vitit 1965, sipas amendimeve të Aktit Asnjë Fëmijë të mos Ngelet Mbrapa (NCLB) të vitit 2001. Megjithatë, ESEA/NCLB , kërkon që prindërit, ose kujdestarët që kanë fëmijë që ndjekin shkollat e Title I të njoftohen për arritjet mësimore të shkollave, si edhe përkrahimin e shkollave sipas “Fleksibilitetit të Heqjes nga ESEA” të Pensilvanisë. Me anën e kësaj letre, po ju ofrojmë informacion shtesë në lidhje me opsionet që janë të mundshme për fëmijën tuaj sipas këtij akti, si dhe t’ju ndihmojmë të kuptoni se çfarë do të thotë “Fleksibiliteti i Heqjes nga ESEA” për ju dhe fëmijën tuaj.

Duke filluar nga viti shkollor 2013-14, PDE nuk do të përdorë Progresin Adekuat Vjetor (AYP) për të përcaktuar kriteret për përmirësimin e shkollës. Në vend të kësaj, në pajtim edhe me “Fleksibilitetin e Heqjes nga ESEA”, PDE do të përdorë katër Objektiva të Matëshme Vjetore (AMO) për përcaktimin e paraqitjes së shkollës. Këto katër AMO_t përfshijnë:

1. Shkalla e Matëshme e pjesëmarrjes në Test
2. Shkalla e Diplomimit/Frekuentimit
3. Mbyllja e Prapambetjes për të gjithë nxënësit
4. Mbyllja e Prapambetjes për nxënësit me histori mosarritjesh.

Këto kriteret të reja të AMO_s , janë përdorur si bazë për shkollat e reja të përcaktuara për Title I, që do të zëvendësojnë përcaktimet e përmirësimit të shkollës. Përcaktimet për Shkollat e reja të Title I janë:

- Në Prioritet
- Në Fokusim
- Në Shpërblim – Progres i Lartë
- Në Shpërblim – Arritje e Lartë

Ju lutemi shikoni bashkëngjitur për kriteret e këtyre përcaktimeve. Në shtesë të katër përcaktimeve të mësipërme, ka shkolla të cilat përcaktohen për “Title I – Pa Përcaktim.”

Të gjitha shkollat publike të shtetit do të klasifikohen në Profilin e Performancës së Shkollës (SPP) me pikë, bazuar në 100 pikë të mundshme. Ky klasifikim, do të konsiderohet si notë për performancën mësimore dhe megjithse nuk do të jetë kriter për përcaktimin e statusit të Shpërblimit, Prioritetit, ose Fokusit, ai do të detajojë performancën e nxënësit, nëpërmjet vlerësimit të shumë treguesve, që përcaktojnë arritjet. SPP gjithashtu përfshin mbështetje në lejimin e shkollave për materiale dhe burime të tjera, që përmirësojnë fushat që lidhen me arritjet mësimore.

Pavarësisht progresit të kryer nga nxënësit tanë, shkollat tona janë përcaktuar si Shkolla Në **Fokusim**. Ky përcaktim është bazuar në rezultatet e të dhënave të testeve të kryera nga viti shkollor 2012-13 dhe ky përcaktim do të ngelet për tre vite.

Si shkollë në **Fokusim**, ne do të punojmë bashkërisht me prindërit/kujdestarët, me komunitetin dhe administratorët tanë, të zhvillojmë një plan për kthesën e plotë, i cili do të realizojë ndërhyrje për nevojat specifike të përmirësimit të gjendjes të nëngrupeve të nxënësve me arritje të ulta. **Ju lutemi kontaktoni personelin e shkollës për ndërhyrjet që do të zbatohen gjatë vitit mësimor 2014-15 .**

Për më tepër rreth Profilit të Performancës së Shkollës, ju lutemi vizitoni uebsajtin:
<http://paschoolperformance.org/>

Me qasjen në uebsajtin e Profilit të Performancës së Shkollave të Pensilvanisë,

- Filloni duke zgjedhur “Role” i “Prind (Në Shtetin)” në fundin e faqes
- Kërkoni për emrin e shkollës

Si pjesë e rëndësishme e suksesit të planit për shkollat tona, është pjesëmarrja dhe mbështetja e prindit për veprimtaritë që përmirësojnë arritjet e nxënësve. Ne shpresojmë, që si prind/kujdestar, ju do të përfshiheni në nismat që përmirësojnë shkollat, ndërsa ne do të vazhdojmë detyrën tonë për arritjet mësimore të nxënësve dhe do të vendosim pritshmëri të larta. Nëse jeni i interesuar në pjesëmarrjen për zhvillimin e nismave për përmirësimin e shkollës, si dhe të mësoni më tepër për Profilin e Performancës së Shkollës, ju lutemi kontaktoni shkollën.

Ju falenderojmë për mbështetjen që bëni për edukimin e fëmijës tuaj.

Sinqerisht,

Drejtori i Shkollës